

## Raport për rezultatet e konsultimeve publike

### 1. Titulli i draft aktit

**Projektvendim “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023””**

### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore, në respektim të ligjit, nga data 29 gusht 2022 deri më datë **26 shtator 2022**, pra jo më e shkurtër se 20 ditë pune.

Gjithashtu takimet paraprake kanë filluar në datën 19 tetor 2021 nga QKEDH deri në datën 3 qershor 2022, që përkon me datën e takimit të mbajtur në Ministrinë së Brendshme.

### 3. Metoda e konsultimit

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Metodat e konsultimit të përdorura për **Projektvendimin “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023””** janë dy:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK për periudhë të paktën 20 ditë pune sipas ligjit, përafërsisht një muaj duke filluar nga data 29 gusht 2022 deri më 26 shtator 2022;
2. Posta elektronike (Email).

Në vijim, janë paraqitur takimet konsultuese të zhvilluara nga Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me ministrinë e linjës në kuadër të strategjisë dhe që me vendimin nr. 737, datë 13.12.2017 “Për ngritjen e qendrës së koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (QKEDH)”, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me VKM nr. 237, datë 20.04.2022, QKEDH kaloi në varësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

**Data****Fusha prioritare****19 tetor 2021**

Takim me përfaqësues të grupit ndërinstitucional për të diskutuar/dakortësuar mbi metodologjinë e zhvillimit të seminareve, për të konsoliduar listën e pjesëmarrësve të institucioneve si dhe për të diskutuar draft objektivat strategjike të tre shtyllave kryesore të Planit Kombëtar.

26 tetor 2021

Fusha e Parandalimit, Përfaqësues nga MD, MB dhe MM

2 nëntor 2021

Fusha e Re-integrimit/rehabilitimit, Përfaqësues nga MD, MB, MAS, SPAK, AISM, AMVV, AMA, Policia e Shtetit

15 nëntor 2021

Fusha e Re-integrimit/rehabilitimit, Përfaqësues nga Policia e Shtetit, AISM, Njësia e Antiterrorit, MD, MAS

1 dhjetor 2021

Takime konsultuese me Përfaqësues nga MD ( Shërbimi i provës, Qendra e parandalimit të krimeve të të miturëve)

2 dhjetor 2021

Takime konsultuese me Përfaqësues nga MB dhe Policia e Shtetit

7 dhjetor 2021

Takime konsultuese me Përfaqësues nga MAS ( ASCAP)

22 dhjetor 2021

Takime konsultuese me Përfaqësues nga MM

24 janar 2022

Takime konsultuese me Përfaqësues nga MFE

Në datën **3 qershor 2022**, zhvilluar takimi i grupit të punës në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

**4. Palët e interesit të përfshira**

*Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:*

**Grupi i punës** i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 73, datë 18.05.2022, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, me përfaqësues të:

- Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në MB;
- Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Drejtorisë së Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPPSH);
- Drejtoria e Antiterrorit në DPPSH;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiare, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në MB
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator;
- Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë, në MB;
- Drejtoria e Konceptimit dhe dhe Fizibilitetit të Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën e Rendit dhe Sigurisë Publike, në MB.

Ky projektvendim është hartuar nga grupi ndër-institucional i punës (GNP) kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm në bashkëpunim me anëtarët e GNP: Ministria e Brendshme, dhe të ftuar nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Komiteti Shtetëror për Kultet.

- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

## 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
